# Rruga e Arbërit

LID LID
LIDHJA E INTELEKTUALËVE DIBRANË

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti I i Botimit. **Nr. 3.** **Korrik 2006** Çmimi: **30** lekë


## Prefekti i Dibrës, z. Xhafer Seiti ekskluzivisht për gazetën "Rruga e Arbërit": Ja problemet në prefekturën e Dibrës



# Seiti: Rruga e Arbërit do të ndërtohet, por kam dëshirë ta ndërtojë qeveria që përfaqësoj



**"Kjo rrugë ka filluar të quhet "Ëndërr dibrane". Nëse të gjithë shqiptarët duan të afrohen me Europën, dibranët në radhë të parë kërkojnë të afrohen me kryeqytetin e tyre. Është e vërtetë që edhe unë kam filluar përpjekjet e mia për të nxitur fillimin e punimeve për të afruar Dibrën me Tiranën. Kam bindjen se kjo rrugë do të bëhet, dikush do ta bëjë dhe ndaj kam dëshirë që ta bëjë qeveria që përfaqësoj. Ndaj dhe këmbëngul."**

INTERVISTA E PLOTË NË FAQET 4-5

## TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS

# Faik Bruçi nuk flet për vete, puna flet shumë për të



Nga SHAQIR SKARRA

Ka kaluar më shumë se një dhjet vjeçarë, që atëherë kur në hapsirat e pafundme të biznesit shqiptar, u shtua dhe një dallëndyshe. Në vitin 1995, Faik Bruçi nga Lukani i Selishtës, në metropolin shqiptar krijoj firmën private "Bruçi Sh.P.K". Megjithse nuk u nis në një stad me të tjerat, megjithse e dinte se do të haste vështirësi dhe pengesa, qoftë burokratike, qoftë dhe juridike, Faiku nuk u tërhoq përballë asnjë llojë vështirësie. Në fillim e nisi në fushën e ndërtimit, një nga fushat dhe sektorët më të vështirë, ku mjaft firma të tjera ngurronin të investonin.

- LEXONI NË FAQEN 3-

*Botohen për herë të parë shënimet e* ***Ismail Strazimirit***




**Si u shkaktue kryengritja e Dibrës dhe përfundimet e kobshme të saj**

FAQE 6

*Reportazh nga Fatos Baxhaku*

**Në Dibër, te pronat e Skënderbeut**

FAQE 7

**Klubi sportiv Korabi tashmë edhe pingpong**

FAQE 8


## NJOFTIM

Njoftohen intelektualët dibranë, të cilët kanë dëshirë të anëtarësohen në shoqatën "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", se për t'u anëtarësuar duhet të plotësojnë "Formularin e anëtarësimit", të cilin mund ta gjejnë pranë redaksisë së gazetës, ose mund ta porosisin nëpërmjet postës elektronike.

Gjithashtu, kujtojmë lexuesit se gazeta "Rruga e Arbërit" është gazetë e pavaruar, botim i Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë. Çdo spekullim me emrin e gazetës nga persona të tjera, nuk ka të bëjë me gazetën dhe shoqatën Lidhja e Intelektualëve Dibranë. Persona që paraqiten si përfaqësues të kësaj gazete janë të pajisur me kartën përkatëse, e cila përmban kokën e gazetës, vulën e shoqatës si dhe firmën e drejtorit të gazetës. Kjo kartë është e vlefshme kur personi është i pajisur me një dokument zyrtar identifikimi. Gjithashtu emrat e tyre janë të shënuar në stafin e gazetës, e cila është e shkruar në faqen 2.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com.

## Ja pse duhet Rruga e Arbërit?

- Ndërtimi i rrugës së 'Arbërit" ka rëndësi të vecanta ekonomike, kulturore e kombëtare jo vetëm për qarkun e Dibrës por hapet drita jeshile për integrim dhe prosperitet të gjithanshëm.
- Dibra njëherë e përgjithmonë do të dilte nga izolimi disa vjecar duke mbetur si aneks i Shqipërisë veri lindore.
- Ndërtimi i kësaj rruge u shërben jo vetëm banorëve të Dibrës, Bulqizës dhe Matit por dhe Durrsit, Tiranës, Elbasanit, Kavajë, Krujë, Kukës, Lezhe e Shkodër. U shërben popullsisë shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Turqi, Bullgari e Rumani.Pra ndërtimi i kësaj nuk është në dobi vetëm të banorëve të Bulqizës dhe Dibrës por përfiton dhe popullsia shqiptare në Maqedoni, përfiton i gjithë Ballkani Qendror.
- Ndërtimi i kësaj rruge bën që Peshkopia,Bulqiza dhe Burreli të kthehen në lagje të kryeqytetit shqiptar.Jo vetëm kaq por dhe krahina e Gollobordës një zonë kjo e izoluar tëerësisht afrohet shumë me metropolin shqiptar.Qyteti i Dibrës afrohet me Tiranën me 83 km.Qyteti i Peshkopisë me 100 km.Gostivari me 141 km.Tetova me 175 km.
- Me ndërtimin e kësaj rruge shfrytëzohet më mirë lugina e Drinit të zi me të gjitha resurset që mban si mermeri dhe kromi, gipsi dhe ujrat termale aq të njohura në Peshkopi.Frutikultura me të gjitha drurët frutor etj.
- Ndërtimi i rrugës së "Arbërit" ka rëndësi për qarkullimin e njerzve si dhe transportin e mallrave brenda dhe jashtë vendit.
- Ka rëndësi të vecantë se shkurton distancën në kilometra jo pak por mbi 110 km ku nëqoftëse Tiranë – Peshkopi bëhej për gjashtë e shtatë orë e cila ishte dhe një tmerr i vërtetë për të sëmurët që donin t'i afroheshin Qendrës spitalore "Nënë Tereza,"po të ndërtohet ruga e "Arbërit" Tiranë –Peshkopi mund të bëhet për një orë e pak minuta.
- Investimi në Peshkopi është më i mundëshëm duke i kthyer disa fshatra si Lura dhe Kalaja e Dodës në fshatra turistik. Kështu që dhe biznesi merr përmasa të mëdha.
- Burreli nuk mbetet aneks siç mundohen të shprehen mjaft analist dhe pushtetar vendor por lidhet më mirë me Tiranën.Me rrugën e "Arbërit është larg vetëm 20 km dhe me rrugën Durrës –Prishtinë afro 40 km.Pra Burreli ndodhet në mes dy koridorëve verior dhe verilindor

-Fshatra të Burrelit si Guri bardhë mund dhe duhet të kthehen në fshatra turistik

-Ndërtimi i rrugës ndalon njëherë e përgjithmonë lëvizjen e pakontrolluar të dibranëve drejt qyteteve të Shqipërisë së mesme



## SHKURT NGA PESHKOPIA

### Policia: Në Dibër nuk mbillet hashash

Në kuadër të luftës kundër kultivimit të bimeve narkotike, policia ka ushtruar kontroll në një numër të madh fshatrash në tërë rrethet e Prefektures së Qarkut të Dibrës. Z. Arsen Iskurti, shef i sektorit të antidrogës në Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Dibrës, thotë se nuk kemi të dhëna për mbjellje të bimëve narkotike në territorin e qarkut, vetëm po verifikohen zonat të cilat në të kaluarën kanë qënë në hartën e kultivimit të hashashit. Deri tani, nga grupet e posaçme të punës janë shkelur një numër i madh fshatrash në komunat malore të rretheve Dibër, Mat e Bulqizë, ku nuk janë konstatuar se ka plantacione të mbjella me bimë narkotike. Gjithashtu, strukturat e policisë në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e pushtetit vendor, kanë zhvilluar një sërë takimesh me fshatarë, ku janë shpërndarë edhe postera me përmbajtje luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

### Stop "punës së zezë"

Nga Drejtoria Rajonale e Inspektoriati te Punes, ka nisur nje kontrolli ne shkalle te gjere neper te gjitha subjektet private, me tematikë punen ne te zeze. Sipas drejtorit te kesaj drejtorie, Ilmi Cani, ne fokusin e kontrollit jane vene te gjitha subjektet private me perjashtim sektorit te ndertimit, i cili eshte kontrolluar dy muaj me pare. Qellimi i kontrollit ka qene konstatimi i sigurimit te punonjesve te ketyre subjekteve ne skemen e sigurimeve shoqerore. Gjate kontrollit jane zbuluar disa subjekte qe punonin pa license, gje qe do te thote, se nuk mund te behet fjale per sigurimin e punonjesve te tyre. Keta ishin subjekte fizike, gje qe i eshte relatuar edhe Drejtorise Rajonale te Tatim – Taksave. Ne keto subjekte te cilat jane kryesisht te linjes se dyqaneve te vogla jane te punesuar mbi 100 persona te cilet punojne te pa siguruar, pra punojne net e zeze. Edhe gjate kontrollit te subjekteve te tjera, ku perfshihen subjektet fizike dhe juridike, te licensuar jane konstatuar gjithashtu shume punëtore te pa siguruar. Sipas Z. Cani, keta subjekte jane detyruar qe te sigurojne punonjesit e tyre dhe jane gjobitur me shuma te ndryshme per shkelje te tilla. Sipas te dhenave ne keta subjekte vec te pasiguruarve punojne edhe femije te mitur, nen moshe. Cani thote se gjate kontrollit nuk kemi konstatuar raste te tilla.

### Tatimet: Evazioni 156 milionë lekë

Dega e Tatimeve në Dibër, ka dërguar për ndjekje penale në prokurorinë e rrethit 20 subjekte të biznesit dibran, sepse nuk i kanë shlyer detyrimet ndaj buxhetit të shtetit, duke krijuar në këtë mënyrë një dëm financiar rreth 156 milionë lekë. Në një njoftim për shtyp të drejtorisë së tatimeve në Dibër, thuhet se janë në procedure edhe dhjetra dosje të tjera për subjektet depitore, të cilat së shpejti do t'i dërgohen prokurorisë. Ndërmjet këtij kontigjenti ka edhe subjekte që kanë krijuar evasion të mirëfilltë fiskal. Gjatë kontrolleve të ushtruara nga policia tatimore, janë zbuluar subjekte të cilat janë krijuar vetëm për të shitur fatura TVSH-je, të cilat janë në proces verifikimi dhe sigurisht që në ditët në vazhdim do të denoncohen në organet hetimore. Në bazë të kodit të procedurës penale të Republikës së Shqipërisë, neni 281., pika1, Drejtoria e Tatimeve ka kërkuar ndjekje penale për subjektet që nuk kane shlyer detyrimet tatimore. Ndërkohe, ndaj tatimpaguesve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e parashikuar me ligj, per procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Sipas ligjit, këto procedura aplikohen në qoftë se edhe pas nxjerrjes së vendimit ekzekutiv për sekuestrimin e pasurive, nuk arrihet të paguhet detyrimi tatimore. Drejtoria e Tatimeve Dibër dhe strukturat e saj do të vazhdojne të kërkojnë zbatimin rigoroz të ligjit dhe do të rrisin përgjegjesinë për të grumbulluar të adhurat që parashikon kuadri ligjor.


## KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI**
Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Hasan Leka.**
**ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë.**
**Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.**
**Email: lid_gazeta@yahoo.com**

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001
Euro 13-661344-0102
USD 13-661344-0203



## NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresa tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179,** ose të na shkruani në **Email: lid_gazeta@yahoo.com**

*Reklamoni biznesin tuaj!*

Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!

Tel.**068 31 19 232.**

Tel: **(04) 357 179.**

*Email:*

**lid_gazeta@yahoo.com**

TË NJOHIM BIZNESMENËT E DIBRËS

# Faik Bruçi nuk flet për vete, puna flet shumë për të



Nga SHAQIR SKARRA

Ka kaluar më shumë se një dhjet vjeçarë, që atëherë kur në hapsirat e pafundme të biznesit shqiptar, u shtua dhe një dallëndyshe. Në vitin 1995, Faik Bruçi nga Lukani i Selishtës, në metropolin shqiptar krijoj firmën private "Bruçi Sh.P.K". Megjithse nuk u nis në një stad me të tjerat, megjithse e dinte se do të haste vështirësi dhe pengesa, qoftë burokratike, qoftë dhe juridike, Faiku nuk u tërhoq përballë asnjë llojë vështirësie.

Në fillim e nisi në fushën e ndërtimit, një nga fushat dhe sektorët më të vështirë, ku mjaft firma të tjera ngurronin të investonin. Faiku mori përsipër të konkurojë bindshëm në këtë sektor për dy arsye: E para, se ishte vetë profesionalisht i aftë, dhe e dyta, se kryeqyteti kishte nevojë të vazhdueshme për ndërtime. Strehimi në Tiranë vlente për të dëshiruar. Sapo kishin filluar ndërtimet e pallateve me dhjetë a më shumë kate, apo siç quheshin ndryshe "gratacelat". Ishin këto ndërtesa që ia ndërruan dhe pamjen kryeqytetit shqiptar, duke e barazuar shpejt nga ndërtimet me kryeqytete europiane.

Firma "Bruçi SHPK" vendosi që investimet e para t'i nis në objekte social kulturore dhe infrastrukturë. Faik Bruçi, si një pinjoll i një dere të fisme dhe arsimdashëse, kishte dëshirë të investonte në arsim. Mungesa e shkollave, por dhe ristrukturimi i tyre, ishte më se i nevojshëm ato vite në vendin tonë.

Nga Tirana Faiku shkoi në Shkodër, te djepi i kulturës shqiptare, ku ndërtoi shkollën "Martin Camaj", një shkollë vërtet me parametra bashkëkohorë. Nga Shkodra në Durrës, ku në kohë rekord ndërton godinën e Universitetit, i cili këtë vit hap dyert për herë të parë për studentët shqiptarë. Por jo vetëm kaq. Kjo firmë tashmë e njohur e shtrinë aktivitetin e saj edhe në fusha të ndryshme si në infrastrukturë dhe ristrukturime të objekteve të rëndësishme.

Pas ndërtimit të një sërë fjetoresh për forcat komando të ushtrisë, bëri dhe ristrukturimin e godinës së Ministrisë së Ekonomisë, ristrukturimin e rrugës së Durrësit, një nga rrugët kryesore hyrëse në kryeqytet, ndërtimin e rrugës Tapizë-Qinam-Çekrezë.

Duke u afirmuar si firmë serioze, duke qenë një ndër firmat më të rregullta taksa paguese, duke kompletuar administratën me kuadrin e nevojshëm inxhiniero-teknik, Faiku hedh vështrimin larg, tepër larg aty ku sapo kishin filluar "gratacelat" e para shqiptare. Ndaj shpejt filloi ndërtimin e një sërë pallatesh shumëkatëshe. Kur shikon komplekset e banimit pranë shkollës teknologjike të ndërtuar nga "Bruçi SHPK", bindesh në seriozitetin dhe profesionalizmin e kësaj firme.

Vetëm nga apartamentet e ndërtuar nga "Bruçi SHPK janë strehuar mbi 300 familje. Nga kjo firmë është ndërtuar deri tani mbi 30000 metra katror apartamente, dyqane, zyra dhe parkime.

## NDRYSHE NGA TË TJERAT

Pas konkurimit në tregun e ndërtimit bashkëkohor, Faik Bruçi gjithë vullnet dhe kurajo, filloi të kërkojë nga vetja, por dhe nga administrata që kishte e tij.

Ishte viti 2002. Në metropolin shqiptar, pas popullimit të menjëhershëm, doli e nevojshme pastrami i kryeqytetit. Ndërmarrja e pastrimit, që mbulonte Bashkia, nuk mund ta përballonte këtë fluks të madh. Faik Bruçi vendosi të marrë mbi supe një përgjegjsi të madhe.Vendosi të bëhej pjesë me shumë firma shqiptare dhe të huaja në pastrimin e Tiranës. Me kuadro, puntorë, por dhe me makineri, mori pjesën më të vështirë për pastrimin e kryeqytetit. Jo vetëm sot, por që nga viti 2002 zona perëndimore, një ndër zonat më të mëdha të Tiranës, pastrohet nga firma "Bruçi SHPK". Pastrimi i Tiranës është një nga sektorët më të vështirë, por për këtë firmë serioze edhe vetë qytetarët flasin me admirim. Bashkë me punëtorët e pastrimit, një pjesë e mirë e administratës natën rrinë zgjuar. Mëngjesi e gjen zonën perëndimore të Tiranës të pastër.

Sot në këtë firmë janë të punësuar mbi 300 puntorë si dhe mbi 30 nëpunës në administratën e firmës. "Shumica e të punësuarve janë dibranë, por ne nuk kemi lënë jashtë portës edhe të tjerë hallexhinj që kanë trokitur në zyrat tona", - thotë Faiku.

## NË PERSPEKTIVË

Faik Bruçi, njeri kurajoz dhe me një vullnet të forte, premton për më shumë. Ambicie ka për punën.

"Deri tani nuk kam dështuar, lus Zotin që të mos dështoj në këtë rrugë që jam nisur. Kam një projekt vërtet madhështor në të ardhmen për të zbatuar dhe jam i bindur se do ta realizoj. Një projekt që ende nuk është ndërtuar tek ne, ku ndërtimi dhe gjelbërimi shkojnë bashkë, bile sipërfaqja e gjelbërt është ndoshta dhe më e madhe. Megjithatë është herët të flasim para kohe. Projekti i këtij kompleksi ka mbaruar. Mbeten vetëm pak procedura dhe në një nga zonat periferike të Tiranës do të shikojmë një kryeqytet krejt ndryshe", thotë Faiku.

Shpresojmë të mos jetë kohë e largët. Puna këmbëngulëse, inisiativa dhe vullneti i Faik Bruçit nuk kanë zhgënjyer njeri.

## JETA

Faik Bruçi u lind më 1 janar të vitit 1956, në fshatin Lukan të katër Grykëve. Familja e tij njihet për atdhetarizëm, besë e bujari, jo vetëm në Dibër, por edhe jashtë saj.

Vetëm pak kohë pasi mbaron arsimin tetëvjeçar në vendlindje, në vitin 1972, largohet nga Lukani i strukur bukur rrëzë maleve dhe shkon në një nga veprat më të mëdha të asaj kohe, Hidrocentralin e Fierzës. Gjatë punës këtu mbaron me nota të mira dhe arsimin e mesëm për gjeometër ndërtimi, profesion që e ka dashur gjithmonë.

Pas mbarimit të shkollës, fillon punë si përgjegjës sektori i laboratorit të Fierzës. Të gjitha analizat laboratorike që zhvilloheshin atëherë për Fierzën, e cila sapo kishte hedhur digën e saj të madhe, i ishin besuar Faik Bruçit nga Dibra. Ky nuk ishte një vlersim i pakët.

Nga vitet 1980 deri në vitin 1985 kalon në një vepër tjetër të madhe energjitike, siç ishte Komani. Edhe këtu punoi me detyrën e përgjegjësit të sektorit.

Në vitet 1985-1988 me ndërmarjen e tensionit të lartë Tiranë.

1988-1990 në ndërmarjen e ndërtimeve industriale.

1990-1992 në ndërmarjen e mirëmbajtjesa së rrugëve.

Faiku është i martuar dhe ka tre fëmijë; një djalë dhe dy vajza. Valbona, vajza e madhe, vazhdon për master menaxhim biznes. Ajo ka pasion edhe letërsinë. Në shkollë të mesme ka botuar vëllimin e parë me poezi "Rruzull ndjenjash", ndërsa ka në proces edhe dy libra të tjerë, me poezi dhe prozë. Fatmira, vajza tjetër, vazhdon studimet në mjekësi, në Florida të SHBA. Ndërsa djali, Fatjoni, vazhdon gjimnazin "Inkus".

Faik Bruçi është anëtar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, ku drejton edhe Komisionin e Ndërtimit.



Valbona Bruçi



*Projekti i një kompleksi banimi të firmës "Bruçi".*



*Universiteti i Durrësit, ndërtuar nga firma "Bruçi".*

*Prefekti i Dibrës, z. Xhafer Seiti ekskluzivisht për gazetën "Rruga e Arbërit": Ja problemet në prefekturën e Dibrës*



# "Rruga e Arbërit do të ndërtohet, por kam dëshirë ta ndërtojë qeveria që përfaqësoj"

**Zoti Seiti, si e nisët punën tuaj në qarkun e Dibrës?**

Më datë 7 tetor 2005 në bazë të marrëveshjes së partive të koalicionit qeverisës, në mjediset e Institucionit të Prefektit të qarkut Dibrës, nga ministri Jemin Gjana, shoqëruar nga një grup deputetësh u prezantova në detyrën e Prefektit.

Me të marrë detyrën shpalosa angazhimin tim për të qenë në çdo moment shërbetor i ligjit dhe për t'u bërë garant i zbatimit të pacënuar të tij nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet qëndrore në nivel vendor. Njëkohësisht kërkova nga administrata angazhim maksimal për të realizuar programin ambicioz të Qeverisë së Re.

**Cilat mendoni ju se janë detyrat kryesore që duhet të kryejë një Prefekt në përgjithësi?**

Në detyrat që cakton ligji "Për Prefektin" primare për t'u vënë në zbatim janë dhe mbeten: Kontrolli i ligjshmërisë së akteve të marra nga organet e qeverisjes vendore, kontrolli i zbatimit të buxhetit nga organet e qeverisjes vendore, gjë për të cilën kam kërkuar angazhim maksimal nga drejtoria e auditit financiar dhe po në zbatim të ligjit të sipërcituar është detyrë e Prefektit të bëjë të gjitha përpjekjet dhe të shfrytëzojë të gjitha hapësirat për të nxitur një bashkëpunim efikas ndërmjet vetë organeve të qeverisjes vendore, administratës dhe këshillave vendorë brenda njësisë dhe këtyre të fundit me administratën e institucioneve qëndrore në nivel vendor, natyrisht duke nxitur dhe bashkërendimin institucional të vetë institucioneve.

**Cilët janë sektorët që u jeni kushtuar më shumë në punën tuaj?**

Rëndësi kanë të gjithë sektorët si ai i arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, shërbimeve ndaj popullatës, rendit e qetësisë, reformave ligjore, turizmit, kulturës, sporteve e të tjera.

**Si i ndiqni ju si Prefekt problemet e arsimit dhe cilat janë kryesisht ato?**

Në institucionin që drejtoj, janë punonjës të ngarkuar për të bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale e Zyrat Arsimore në rrethe për të ndjekur këto probleme dhe për të raportuar te Prefekti. Veç kësaj, vetë kam gjetur kohën dhe kam marrë pjesë në të gjitha analizat e arsimit dhe veprimtari të tjera të këtij sektori, ku kam ngritur probleme që i kam konsideruar shqetësuese, kam kërkuar zbatim e zgjidhje.

Shqetësimet që kam shtruar para drejtuesve të arsimit shprehin interesin për arsimin parashkollor me gamën e problemeve, arsimin 9-vjeçar e të mesëm, veçanërisht atë profesional, nivel dhe cilësinë e kalueshmërisë, fenomenet që përbëjnë raste shkeljesh ligjore në fushën e arsimit, nevojën e plotësimit të kushteve normale për mësim dhe bazë materiale e laboratorike të plotë.

**ARSIMI**

**"Kam kërkuar një politikë më profesionale në emërimin e kuadrit, ndërhyrjen e Qeverisë për të stimuluar mësuesit që duan të punojnë në zona të thella, krijimin e mundësisë për hapjen e ndonjë filiali, pse jo dhe të një universiteti, qoftë dhe Part Time për gjithë këtë zonë të veçuar, ndofta dhe trajtim të diferencuar për të vazhduar shkollën e lartë për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm në zonat e thella të qarkut."**

Nisur nga problemet kam kërkuar që në kushtet aktuale, në arsim të ketë një organizim dhe drejtim më operativ dhe shkencor, të rritet bashkëpunimi mes drejtorive arsimore e atyre të shkollave me organet e qeverisjes vendore, të rritet puna studimore dhe edukative, të vlerësohet e të punohet më shumë për eleminimin e rasteve të braktisjes së shkollës nga nxënësit, të forcohet lidhja e shkollës me komunitetin.

Gjithashtu kam kërkuar një politikë më profesionale në emërimin e kuadrit, ndërhyrjen e Qeverisë për të stimuluar mësuesit që duan të punojnë në zona të thella, krijimin e mundësisë për hapjen e ndonjë filiali, pse jo dhe të një universiteti, qoftë dhe Part Time për gjithë këtë zonë të veçuar, ndofta dhe trajtim të diferencuar për të vazhduar shkollën e lartë për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm në zonat e thella të qarkut.

**Po për shëndetësinë, cilat janë problemet?**

Si prefekt kam vlerësuar punën dhe shtruar detyra konkrete dhe për shëndetësinë. Kam vlerësuar kujdesin e treguar për realizimin në sasi e cilësi të investimeve, kontributin maksimal dhënë nga shëndetësia në përgjithësi dhe Ministria për rastet emergjente, shërbimet cilësore në spitale të veçanta me numër të lartë të të shtruarve, të kuruarve, të operuarve, uljen e vdekshmërisë, mjediset e kulturuara në disa pavione. Këto e të tjera i kam konsideruar dhe propaganduar si tregues të punës së mirë nga punonjësit dhe drejtuesit e shëndetësisë.

**SHENDETESI**

**"Kam kërkuar disiplinimin e punës së mjekëve që punojnë në zona, krijimin e kushteve mjedisore, rritjen e prestigjit dhe personalitetit të punonjësve të shëndetësisë, shmangies së rasteve të mitmarrjes, zgjidhjen përfundimtare të problemit të shërbimit stomatologjik, evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, eleminimin e rasteve joligjore të vendosjes së terapisë nga mjekët, modernizimin e shërbimit të urgjencës..."**

Por, nisur nga fakti që shëndetësia është e lidhur ngushtësisht me jetën e njeriut, kam kërkuar që drejtuesit të jenë më kërkues për disiplinën shkencore në punë si në spitale, ashtu dhe në qendrat shëndetësore, veçanërisht te këta të fundit në rritjen e efiçencës së punës së kuadrit të mesëm dhe kontrollit më të plotë të tyre nga mjekët e qendrave shëndetësore, disiplinimin e punës së mjekëve që punojnë në zona, shtimin e afimitetit shkencor me të sëmurët, krijimin e kushteve mjedisore për një shërim sa më të shpejtë, rritjen e prestigjit dhe personalitetit të punonjësve të shëndetësisë nëpërmjet shmangies së rasteve të mitmarrjes, krijimin e një imazhi të ri për punën e personelit shëndetësor, zgjidhjen përfundimtare të problemit të shërbimit stomatologjik, veçanërisht në shkolla, disiplinimin e punës në këtë sektor, sipas ligjeve në fuqi, evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave dhe marrjen e masave për eleminimin e pasojave të tyre, eleminimin e rasteve joligjore të vendosjes së terapisë nga mjekët, përdorimin efiçent të medikamenteve për pacientët, modernizimin e shërbimit të urgjencës, perfeksionimin e punës me komisionet mjekësore, të mjekëve të familjes, disiplinimin e dhënies së recetave me rimbursim, eleminimin e rasteve abuzive, rritjen e kujdesit për kontrollin e higjienizmit në përgjithësi e atë në vende publike në veçanti, pajisjen me libreza shëndetësore, klorofikimin sistematik të ujit të pijshëm, parandalimin e sëmundjeve infektive e epidemike, mirëpërdorimin e shpenzimeve operative, zgjidhje ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë për ndalimin e tregtimit të detergjentëve në farmacitë me kontratë shtetërore për ilaçet me rimbursim, gjetjen e rrugëve për realizimin normal të furnizimit me materiale të buta, saktësimin e komptencave ligjore të secilës drejtori, ndofta nëpërmjet një akti të specifikuar nënligjor, një bashkëpunim korrekt me Organet e Qeverisjes Vendore dhe llojet e ndryshme si atë tatimore, të rendit, sipas përkatësisë së problemeve etj.

**Për herë të parë Prefektura si institucion dhe ju personalisht, keni ngritur fort problemin e "Rrugës së Arbërit". Si e mendoni institucionalisht këtë problem?**

Natyrisht! Më keni prekur aty ku unë e quaj "Thembra e Akilit". Kjo rrugë ka filluar të quhet "Ëndërr dibrane". Nëse të gjithë shqiptarët duan të afrohen me Europën, dibranët në radhë të parë kërkojnë të afrohen me kryeqytetin e tyre. Është e vërtetë që edhe unë kam filluar përpjekjet e mia për të nxitur fillimin e punimeve për të afruar Dibrën me Tiranën. Kam bindjen se kjo rrugë do të bëhet, dikush do ta bëjë dhe ndaj kam dëshirë që ta bëjë qeveria që përfaqësoj. Ndaj dhe këmbëngul.

Problemin e gjeta të nisur. Kërkesat e komunitetit drejtuar Prefekturës kishin filluar që në vitin 1996. Unë si Prefekt, duke qenë dakord me mendimin e njëzëshëm të të gjithë faktorëve në qarkun e Dibrës, të intelektualëve, specialistëve, drejtuesve të organeve të qeverisjes vendore, biznesmenëve e njerëzve të thjeshtë, së bashku me Organin këshillues pranë meje, kemi përcaktuar prioritet të prioriteteve për qarkun Dibër, ndërtimin e rrugës Peshkopi-Tiranë në aksin e quajtur "Rruga e Arbërit" dhe për këtë, me një shkresë zyrtare, ku kemi dhënë argumenta për nevojën dhe përparësitë që ka qarku i Dibrës me ndërtimin e kësaj rruge, iu drejtuam Kryeministrit të Shqipërisë, Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve, Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm dhe 14 Deputetëve, që kanë lidhje me Dibrën dhe komunitetin e kësaj treve, për t'i sensibilizuar me faktin e pamohueshëm se ndërtimi i kësaj rruge e nxjerr Dibrën nga izolimi i sotëm, e afron atë me Tiranën e gjithë Shqipërinë, ndaj dhe ajo duhet filluar sa më parë.

**A mbetet fillimi i punimeve një prioritet në punën tuaj?**

Po. Në të gjitha takimet me të huajt kam këmbëngulur në nevojën e ndërtimit të kësaj rruge, gjë për të cilën u kam parashtruar atyre edhe një sërë argumentash për domosdoshmërinë e ndërtimit të saj.

Lashtësia e kësaj rruge, shkurtimi i distancës Tiranë – Peshkopi me 83 km, rëndësinë e jashtëzakonshme ekonomike, kulturore e kombëtare për qarkun e Dibrës dhe më tej, hapja e dritës jeshile për integrim mbarëkombëtar dhe prosperitet të gjithanshëm, nxjerrja e Dibrës nga izolimi i sotëm e konsiderimi si "një xhep" anësor i Shqipërisë, integrimi i një popullsi prej rreth



**Kjo rrugë ka filluar të quhet "Ëndërr dibrane". Nëse të gjithë shqiptarët duan të afrohen me Europën, dibranët në radhë të parë kërkojnë të afrohen me kryeqytetin e tyre. Është e vërtetë që edhe unë kam filluar përpjekjet e mia për të nxitur fillimin e punimeve për të afruar Dibrën me Tiranën. Kam bindjen se kjo rrugë do të bëhet, dikush do ta bëjë dhe ndaj kam dëshirë që ta bëjë qeveria që përfaqësoj. Ndaj dhe këmbëngul.**

2.5 milionë banorë në shumë qytete e rrethe brenda e jashtë Shqipërisë, janë disa nga argumentat tona, mbështetur edhe në kërkesat e njëpasnjëshme që Shoqata "Nisma Dibrane" ka depozituar në prefekturë që më 4 janar 1996 e në vazhdim.

Kemi sqaruar këto institucione se po të ndërtohet kjo rrugë ndikimi pozitiv në zhvillimin e biznesit është në përmasa të pallogaritshme, ndalon migrimin e pakontrolluar, të pamotivuar e të pavend të qytetarëve dibranë, bulqizakë e matjanë drejt qyteteve të tjera, është faktor i rëndësishëm për rritjen e investimeve të huaja e të brendshme si dhe i jep një shtytje shumë të fuqishme zhvillimit të turizmit, për të cilin resurset në qarkun e Dibrës janë të mrekullueshmë. Me ndërtimin e kësaj rruge Dibra nuk zvarritet më drejt progresit, por e ardhmja fluturon vetë drejt saj. Ajo që vlen të theksoj është se koha e përllogaritur e mbulimit të shpenzimeve për këtë rrugë është shumë e shkurtër.

Ka plot argumente të tjera, të cilat ne jemi përpjekur t'ja pasqyrojmë edhe më hollësisht Qeverisë dhe institucioneve të interesuara.

**Zoti Prefekt, personalisht a keni besim se kjo rrugë do të ndërtohet?**

Po. Kam shumë, shumë besim. Ndërhyrja e Qeverisë do ta realizojë këtë ëndërr.

**Ju këmbëngulni në domosdoshmërinë e ndërhyrjes së Qeverisë si për Rrugën e Arbërit, ashtu dhe për probleme të tjera. Po ku konkretisht?**

Unë jam Prefekt dhe përfaqësues i Qeverisë në rajon. Ecja mirë e qarkut është tregues i ecjes mirë të Qeverisë. Pra, është detyrë thelbësore e çdo prefekti që të përçojë aty ku punon politikën e qeverisë së vet. Natyrisht që në qark ka dhe probleme që nuk varen e nuk mund të zgjidhen në organet e qeverisjes vendore dhe institucionet qëndrore në nivel vendor, por kërkojnë dhe ndihmën e shtetit nëpërmjet Ministrive sipas përkatësisë. Aq më imediate bëhet kjo kur shikon kompetencat e pakta që ka Prefekti sipas ligjit ekzistues. Kontradita në gjykimin tim qëndron në faktin se në njërën anë Prefekti emërohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Kryeministrit si përfaqësues i Qeverisë, e nga ana tjetër ky përfaqësues nuk ka të drejtë ligjore të emërojë e shkarkojë një drejtor vendor apo rajonal, por duhet të bëjë propozime apo rekomandime te Ministrat përkatës. Ndaj dhe prefekti për problemet që ka drejtohet për ndihmë te Ministrat për probleme të veçanta sipas përkatësisë. Dhe këtë e kemi bërë pothuajse për të gjithë Ministrat.

Për një pjesë të problemeve që kam ngritur për ministritë, kam vënë në dijeni dhe Kryeministrin, duke gjykuar se problemet e kanë atë rëndësi që të jenë dhe në dijeninë e tij.

**Kam kërkuar që institucioni i Prefektit të vihet në dijeni të çdo investimi që kryhet në rajon, pas Prefekti është përfaqësues i Qeverisë në qark dhe vetë ligji e ngarkon që të raportojë për realizimin periodik të investimeve dhe problemet me to. E thënë qartë e shkoqur, ideja ime është që tanimë investimet nga donatorët duhet të dalin nga cikli i mbyllur.**

**Diku më lart cekët problemin e kompetencave të pakta të prefektit, gjë që nënkupton nevojën për ndryshime ligjore për sa sipër. Po në përgjithësi a mendoni se ka vend për ndryshimin e metodës së punës dhe ndryshime në ligje që kanë të bëjnë me punën tuaj dhe nëse po cilët janë disa prej tyre?**

Në bazë të ligjit, për të gjitha problemet, kam informuar me shkrim çdo javë si Ministrinë e Brendëshme, ashtu dhe Këshillin e Ministrave.

Në këto informacione kam ngritur dhe probleme të veçanta, të cilat kam gjykuar se duan ndërhyrjen e Qeverisë për përmirësimin e metodës së trashëguar të punës dhe ndryshimeve ligjore, ndër të cilat veçojmë:

Së pari problemi i investimeve: Ndërsa nga donatorë të ndryshëm që menaxhohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka informacion periodik për punën e kryer, për ecurinë e saj, ftohet institucioni i Prefektit që të dërgojë vëzhgues për tenderimet, nga disa donatorë të tjerë bëhen ivnestime për të cilat Prefekti nuk ka asnjë lloj dijenie se kush investon, me kë kanë kontaktuar për investimin, kanë apo jo leje për ndërtimet që bëjnë, janë diskutuar apo jo në organet e qeverisjes vendore, ka një vendim të këshillit përkatës, janë diskutuar në komunitete, kanë apo jo marrëveshje me pronarët, sa është fondi i investimit, si menaxhohet, kush e kontrollon dhe kjo ndodh pasi veprimet financiare nuk kalojnë nga buxheti e thesari, ku të paktën mund të merret dijeni shifrore, etj.

Kam kërkuar që institucioni i Prefektit të vihet në dijeni të çdo investimi që kryhet në rajon, pas Prefekti është përfaqësues i Qeverisë në qark dhe vetë ligji e ngarkon që të raportojë për realizimin periodik të investimeve dhe problemet me to. E thënë qartë e shkoqur, ideja ime është që tanimë investimet nga donatorët duhet të dalin nga cikli i mbyllur.

Po në këtë kuadër gjykoj se dhënia e investimeve për objekte të veçanta në shuma pjesore, zgjat kohën e vënies në punë dhe ul efektivitetin e investimeve në objekte të njëjta, përfundimi i një objekti e më pas fillimi i tjetrit të të njëjtit lloj.

Kam shprehur mendimin se për ecurinë normale të problemit të investimeve ka nevojë dhe për ndryshime në ligj pasi: Ulja e shumave të akorduara gjatë proceseve tenderuese, ul cilësinë e objekteve; përqëndrimi i kryerjes së procedurave të prokurimeve nga disa Digastere e Institucione të tjera qëndrore, jo gjithmonë ka qenë rezultativ, në raste të veçanta kanë mbetur tenderime të pazhvilluara e për rrjedhojë edhe objekte të papërfunduara. Po kështu jo rezultativ quaj dhe planifikimin dhe shpërndarjen e investimeve për arsimin dhe shëndetësinë nga Këshillat e Qarqeve, këto investime gjykoj se duhet t'i shpërndajnë drejtoritë apo Ministritë përkatëse, pasi janë ato që e njohin gjendjen.

Kryerja e investimeve për sistemin rrugor Nacional e Rural nga firma të ndryshme private me fonde të Bankës Botërore, realisht nuk ka qenë rezultative. Sipërmarrësit me punën e tyre nuk kanë justifikuar veten. Ndarja e rrugëve Nacionale, Rurale, Komunale si dhe ato të marra me koncesion, krijojnë një shpërndarje përgjegjësie.

Së dyti për probleme të tjera: Vetë Institucioni i Prefektit ka detyrime të mbartura nga ish-këshillat e rretheve ndaj të tretëve sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në vlerën 4.6 milionë lekë.

Për këtë problem ndër vite me një numër të konsiderueshëm shkresash Prefektët u janë drejtuar Digastereve dhe Institucioneve të tjera Qëndrore, përfshirë dhe Këshillin e Ministrave për interpretim dhe ndërhyrje për zgjidhje. Këtë kam bërë dhe unë, por akoma nuk ka një zgjidhje. Institucionit të Prefektit i ngarkohet të shlyejë vendime gjyqi, deri dhe të vitit 1996, kur nuk ka asnjë lloj financimi për to.

Në këtë kuadër gjykojmë të nevojshme nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e nenit 75 të ligjit 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore".

Në vitin 2003 u shtuan organikat e Institucionit të Prefektit me nënprefekturat dhe Komisionin e Kthimit dhe kompensimit të pronave, ndërsa buxheti i vitit 2003 për shpenzime operative ishte 50% më i vogël se ai i vitit 2002, gjë që ka krijuar rritjen e detyrimeve ndaj të tretëve, detyrim që dot shkon në 4.2 milion lekë. Natyrisht pa një ndërhyrje të Qeverisë këto detyrime nuk mund të shlyhen.

Edhe për PMNZSH-në për vitin 2005 fondi i shpenzimeve operative është ulur 50% dhe me rëndësinë që ka sektori me këto fonde nuk mund të realizojë asnjë nga detyrat e planifikuara, ato nuk mjaftojnë për shlyerjen e qerasë së objektit dhe karburant duke shkuar drejt inaktivitetit dhe formalitetit.

Institucioni i Prefektit ka nevojë dhe për kushte pune, për investime për vetë institucionin dhe PMNZSH-në, ka nevojë për pajisje me mjete lëvizëse, pasi nuk ka asnjë të tillë në gjendje pune, as vetë Prefekti.

Duhet ndërhyrje dhe në ligjin "Për Prefektin" për t'i dhënë kompetenca vetë Prefektit, përfaqësues i Qeverisë në qark, që të ketë të drejtë të emërojë dhe largojë nga detyra drejtuesit e institucioneve qëndrore në nivel vendor me veprimtari në shkallë qarku e pas rrethesh në të mirë të punës. Prefekti duhet t'i jepen kompetenca ekzekutive për evadimin e materialeve të auditeve të ushtruara pranë OQV-ve, pasi rekomandimet e dhëna nga Prefekti, sipas ligjit të sotëm, në evadimin e këtyre materialeve përgjithësisht nuk gjejnë zbatim.

Në ligjin "Për Emergjencat Civile" prefekti njihet përgjegjësi kryesor në qark, por nuk ka as kompetenca urdhëruese, as fonde përkatëse.

Së treti për marrëdhëniet në Ministritë: Marrëdhëniet e Institucionit të Prefektit me ministritë apo digasteret qëndrore në shumicën e rasteve kanë qenë korrekte dhe ligjore. Nga ana e Prefektit nuk ka munguar në asnjë rast informimi periodik si për MB, ashtu dhe për Këshillin e Ministrave apo për Ministri të veçanta sipas problemeve që kanë lindur. Por ka pasur dhe ndonjë rast kur nga Ministritë apo pjesë të tyre ka munguar kjo korrektësi.

Institucionet Qëndrore të veçanta, duke filluar nga Ministritë, nuk dërgojnë pranë Prefektit, aktet e nxjerra prej tyre, ndonëse institucioni i Prefektit është i ngarkuar të ndjekë zbatimin e ligjshmërisë.

Institucionet Qëndrore nuk vënë në dijeni paraprakisht Prefektin për kontrollet që ushtrojnë në institucionet e vartësisë së tyre në qark dhe sipas rretheve dhe nuk e njohin me rezultatet e këtyre kontrolleve.

Ministritë jo sa duhet orientojnë drejtuesit e institucioneve të vartësisë në qark e rrethe për të informuar Prefektin për veprimtaritë e tyre.

Në institucionet qëndrore në nivel vendor, nga drejtuesit e tyre në përgjithësi vihet re angazhimi për të realizuar programin e Qeverisë në sektorët që mbulojnë, por në ditët e sotme kërkohet një shkundje e plotë nga uniformiteti apo plogështia e një pjese të tyre dhe këtë në radhë të parë duhet ta bëjnë Ministritë e linjës.

***Bisedoi: Mirvet Lala***

(Vijon nga numri i kaluar)

*Botohen për herë të parë shënimet e* ***Ismail Strazimirit***

# Si u shkaktue kryengritja e Dibrës dhe përfundimet e kobshme të saj



Me 21 shtator 1913 një katundari nga fisi Xhedik Dardhës i quajtur Selahedin, tregtari i katundit, një vllah, i ra me shpullë. Për këtë shkak katundari e vrau tregtarin. Kjo ngjarje ordinere që muer trajtën e një kryengritjeje u konsiderue si kryengritje prej qendrës së prefekturës serbe, e cila burgosi tridhet e gjashtë vetë nga paresia e qytetit të Dibrës së Madhe, të cilëve u thoshte se do ti vriste po të mos dilshin me e ndalue Isa Boletinin. Simbas mendimit të tyre, ai s'kishte kurgja që t'i tmerronte serbët. Autori i kësaj vepre ato ditë ndodhej në katundin Maqellarë afër qytetit. U takue me Halil Kaloshin e Selman Alinë, prinjsa të kryengritjes, të cilët i pyeti mbi kryengritjen e fillueshme. Përgjigja e tyre që helmatuese, sepse ata, të mërzitun nga përdhunimet e administratës serbe dhe t'inkurajuem nga premtimi i përkrahjes me fuqi të Esat Toptanit, në një rast të tillë, i kishin kundërshtue armikut. Kjo ishte një katastrofë për gjithë Dibrën, sepse këta burra trima, por injorantë o naivë, të mbeshtetun në premtimet gënjeshtare t'Esatit kishin dashtë t'ja kthejnë vendit lirinë e grabitur, por mjerisht e plandosën në humnerën e tmerrshme ku veproj ç'njerëzimi, padrejtesia, paburrnija mjerimi dhe vdekja. Ushtrija Serbe po prapsej rregullisht. Malsorët që s'ishin ma shumë se dyqind vetë, tue luftue heroikisht me ushtrinë serbe po sulmojshin dhe po e pushtonin qytetin e Dibrës së Madhe. Ndërkohë, serbët vunë në plumb tridhjet e gjashtë vetë që kishin burgosë. Ndërkohë, u vranë Sheh Hysen Kuci, Sadulla Strazimiri, Ramiz Bej Allajbegija, Safet Bej Kodra dhe Cane Liman Hasani. Sa u lirue qyteti prej ushtrisë serbe, u formue një komisjon për administrimin e vendit. Një pjesë e malsorëve bashkë me qytetarët e ndoqën ushtrinë serbe që po ikte e shkatërrueme dhe e mundën plotësisht drejt Grykës së Radikës. Shtatëmbëdhjet topa, disa mitraloza e nji sasi e madhe municion mbet në duar të shqiptarëve prej ish fuqive zotnuese të këtij vendi. Fuqitë popullore apo kombëtare patën përparue nga ana e Shkupit deri ke hanet e Zdunjës afër Gostivarit, nga ana e Manastirit deri ke mali i Petrinës, që asht ndermjet Ohrit dhe Respës dhe nga ana e Kërcovës deri në malet e James. Komisioni i formuem për administimin e vëndit me nji anë çonte ndër Ballina ushqim e forca ndimëse dhe mbane tjetër hynte në korespondencë me qeverinë e përkohshmetë të Shqipënis në Vlorë, prej secilës kërkonte ndihmë. Por për të keq, prej kërkund nuk mirrte ndihmë. Vetëm njani nga kryetarët e Komitëve Maqëdonas i quajtun Miladon, ç'aso kohe kishte ndodh n'Elbasan, arrin në Dibër dhe u dha kushtimin Maqedonasve të qarkut, por simbas zakonit tradisjonal malësorët u vunë në plaçkitje, qytetarët tue mendue përfundimin e kobshëm të kësaj aventure të rrëzikshme zunë me i ngritë familjet dhe nuk po shkojshin ma në ballë të luftës. Selman Alia nga Çidhma që thoshte se Serbit do ta dëbojmë deri në Beligrad u shkëput nga balli i luftës tue thanë se do të shkonte me mbledhe fuqina të reja dhe i vëllaji i tij, Fejzë Alija, po kthehesh në shtëpi me një tufë bagëti q'i kishte rrëmbye andej. Aso kohe pat ardhë nga Tirana në Dibër Ali Bej Zaimi. Ky tha se në qoftë se komisioni, i formue në Dibër, i shkruen Esat Pashës ai ka për t'arrit me ndihmë, me fuqi të madhe. Shtonte se edhe Esat Pasha e kishte njoftue popullin me anë të kasneceve që të rrinte gati për me shkue në ndihmë të Dibrës e të mblidhesh menjëherëherë, po sa të ndëgjoj krismën e topit që do të zbrazej në raste nëvoje. Mbasandej qe marrë vesht se Esati këtë fuqi në vënd që ta niste në ndihmë të Dibrës, e çoi nga ana e Lushnjës meqëllim që të rrëzonte qeverinë e përkohshme të Ismail Qemalit. Ali Beu mund të kishte dijeni mbi lidhjen pansllave të bërë në Shkodër ndërmjet Eastit e shteteve fqinj. Mënyra e lidhjes meriton të thellohet;përsa kemi ndigjue lidhja ishte kjo;"Serbët e merrshin krejt Prefekturën e Dibrës dhe ngjiteshin deri në Qaf-Bullë e Qafë Mure, Shkodra i lëshohej Malit të Zi. Kthella e Mirditës deri n'ujë të Malit do të përbajshin njëfarë principate, e cila do të sundohej praj Preng Bib Dod Pashës, Shqipëria e jugut copëtohej në pjesë të vogla kontonesh dhe të gjitha këto do të lidheshin me Shqipnin e mesme, e cila do të ishte si kryeprincipatë dhe Esat Pasha Princ. Ali Bej Zajmi fliste për patriotizmin e pashoqë t Esat Toptanit dhe përpiqesh me i tërheqë zemrat e dibranëve kah Esat Pasha. Suksesin e parë e siguroj me këtë mënyrë;Mbas insistimit të tij iu shkrue letra Esatit. Këjo iu dërgue me anë të Hafuz Hysni Kerliut, i cili u ngarkue që të sjellë edhe municion nga Tirana. Me gjithqë në Tiranë ndodhej nji sasi e madhe armësh dhe shumë municion kuajt e dërguem i kthyen zbrazët, sepse Pasha kishte qënë i akupuem me ekspeditën që bante në drejtim të Lushnjës kundër qeverisë së përkohëshme të Vlorës. Veç kësaj, Pasha shkaktoi edhe vonesën e nisjes për Dibër t'Ahmet Bej Zogut, i cili ma në fund arrini në ndimë një fuqi. Serbët suallën fuqina të mëdha ushtarake për me e shtypë kryengritjen e Dibrës. Fuqit tona kombëtare nga ana e Gostivarit u thyen. Po sa u muer vesht ky lajm, komisioni kombëtar ngakoi Ali Bej Zajmin, Kurt Hoxhën nga Muhrri dhe autorin e kësaj vepre me shkue në ballë të luftës por me i rregullue fuqit dhe me rifillue nga veprimet luftarake. Na, mbas disa përpjekjeve të vogla që bamë në disa vise, u kthyem prap dhe erdhëm në mal mbi qytet të Dibrës. Nata e fundme e katastrofës që me 1Gusht 1913. Ishim rreth qytetit dhe në brigjet e katundit Radiçice. Atë natë Ahmet Bej Zogu na kishte ardhë në ndihmë me nja njiqindë e pesëdhjet Matjanë. Këtë fuqi e vendosi ndër pozicione për qëndresë. Qytetarët atë natë po emigroheshin dhe me lot ndër sy e me helm në zemër, po i thojshin lamtumirë prehjes, pasunisë, lumnisë dhe vendlindjes që po lejshin mrapa. Serbët po i digshin katundet që pushtojshin. Tymi dhe flaka ngjitej deri në qiell. Ma në fund dogjën Shadrinjen dhe Kosovrasin. Të nesërmen kosovrasasit, për herën e fundme, i vunë pushkën ushtrisë serbe që po djergesh nëpër grykë të Radikës, por pa dobi. Ahmet beu i dha urdhër fuqisë që të prapsej, sepse qyteti ishte zbrazur. Municionet, ushqime dhe ndihma mungojshin. Aso kohe Elez Jusufi ndodhej në Shkodër. Mbas lajmit që merr prej Vlone menjëherë u nis dhe erdh në Dibër me një shpejtësi të madhe ku mblodhi nga pesë a gjashtëqind vetë prej Kalisi, Dardhë e Reç dhe vrapoi e shkoi deri ke malet e Mavrovës por ishte tepër vonë mbasi ushtritë serbe ishin djergë poshtë dhe populli ishte arratisë. Shpedita e Elez Jusufit nuk i vlejti çështjes, por u zbraps si të tjerat. Ushtritë Serbe therën e masakruen në Gostivar nja pesëdhjet a gjashtëdhjet Dibranë ndër të cilët Riza Elmaz Hiskun, Idris Eteme. Prapanikun e Muharrem Bajram Prapanikun që u ndodhën aty për punë private. Gjithashtu ushtrija Serbe që vinte nga Manastiri kundër Dibrës së robnueme mbyti në Resnë tue i varrue për së gjalli këto Dibranë që ndeshi në Manastir;Sherif Ibrahim Dacin, Murat Jahja Dacin, Shyqri Qapen, Fuat Hajredin Hoxhë Imerin, Rakip Pitarkën dhe Vehbi Ali Fishekun. Veç këtyre fuqit Serbe vranë në rrugë ndërmjet Ohrit e Strugës dhe Hamit Hajredin Haxhi Ymerin, Uko Prapanikun, Mustafa Prapanikun dhe Behxhet Hoxhmedin Prapanikun, të cilët i mbytën tue i lidhë për fyti me tela telefoni dhe i grupuen në një grumbull plehi. Shaqir Bej Jegeni q'ase kohe pat qëllue në Manastir qe arrestue prej autoritetëve Serbe dhe që nise për në Dibër nën një roje të fortë. Të gjitha këto viktima qenë nga qyteti i Dibrës së madhe dhe shumë më parë se të plaste kryengritja patën shkue nëpër viset e përmendura për tregti e punë private. Shumica e këtyne martirve qenë djem të ri që se kishin kalue moshën njëzet e pesë vjeçare që të gjithë të pafajshëm, s'kishin asnjë dije as lidhje me kryengritjen e kobëshme. Malsorët, në luftë e sipër patën zanë rob nja treqind Serbë banorët e qytetit të Dibrës së madhe i mbajtën fare mirë këta, e jo vetëm që i ushqyen por dhe shëruen të plagosunit megjithë forcat serbe u kthyen triumfues përsëqri në qytet. Gati të gjithë banorët e qytetit sikurse të krahinave që përfshin. Dibra qenë arratisë e emigrue. Asnjë e njizeta e qytetarëve s'kishte mbetë në Dibër dhe këta përbajshin një turmë pleqsh, të shumtët të gjymtuen e të sëmunë. Megjith këtë, që të gjithë i kishin dalë para ushtrisë serbe që po futesh në qytet, ngadhnjyesë. Por bashkë me këto fatzi kishin dalur përpara edhe ata treqind e disa Serbë të robnuem prej malsorëve që ishin hospitalizue fare mirë prej qytetarëve. Këta Serb që kishin nji fare dyterimi moral kundrejt dibranëve, iu lutën komandantit Serb që të mos u cënohesh qytetarëve e drejta e jetës dhe e pasunisë mbasi ata jetën e vet ua detyrojshin këtyne. Lutjet e tyne s'ban as më të voglin efekt. Komandanti serb sa hyni në qytet vrau me plumb kryetarin e bashkësisë Behxhet Xhemal Agollin, Kurtish Erebarën, Reshit Kusarin, Gani Rushit Bojaxhiun, Selim Kodrën, Nexhmedin Kodrën që kishin dalë me e pritë si Hysni Halil Qylafku, Reshit Pocesta, e shoqja e Tahir Trepçës, Dudija, të gjallë u futën e u mbytën ndër puse. Qyteti i Dibrës u plaçkit krejt. Mobilet e kushtueshme u çuen në Beligrad. Edhe Luma tue pandeh se kryengritja Dibrës ishte e pregatitun muer pjesë edhe i ndoq Serbët deri në Zhur afër Prizrenit. Për këtë shkak edhe ata pësuan dame të mëdha;Edhe atje si në Dibër u dogjën me mija njerëz. Qytetarët e Dibrës së Madhe pësuan ma shumë dame, sepse zotnij s'qenë të zotët me i marrë të hollat nga kasat dhe shumë zonja s'mundën me i marrë stolitë e kushtueshme që kishin ndër arka, për arsye se ikja u ba befas dhe tmerri i armikut të pamëshirëshëm qe shumë më i madh se sa vlera e të hollave e gjanave të kushtueshme.

## *Koha e emigrimit*

Gati krejt banorët e qytetit dhe një pjesë e madhe prej katundeve, siç thamë edhe ma naltë, u arratisën. Pjesa ma e madhe e emigrantëve u refugjue në Tiranë, tjetra në Elbasan. Bashkia e Tiranës ashtu dhe ajo e Elbasanit zunë me dhanë bukë për ushqim emigrantëve. Emigrantëve që ndodheshin në Tiranë Esat Pasha u nipte mjaft ushqime dhe me qëllime djallzore i gabonte tue i ngushullue kso dore. "Mos u mërzitni ju se nuk ju la që të vuni, në mos ju mjafton buka që ju jep bashkia, jam gati t'i hap hambarët e mij, në të cilat kam njizet mijë qae kollomoq. Unë pasuninë do ta ha me ju, dhe Dibrën në mos me luftë, me të holla kam me e lirue". Megjithse këto premtime djallzore s'duhet ta mashtrojshin dhe atë ma ta humbnin prej Dibranëve, për fat të keq, nji pjesë e dorës së dytë të parësisë dhe e qytetarëve të Dibrës i besoi dhe nisën me i urue jet e fat Pashës shpirt zi. Aso kohe, auktorin e kësaj vepre fati e pat hedhë n'Elbasan si emigrant. Komisioni i formuem në bashki, për ushqimin e emigrantëve me dy tre të tjerë e patën thirrë njëherë dhe e patën pyet se cilët dibranë ishin nevojarë për ushqim dhe cillët ishin në gjendje të mirë e s'kishin nevojë për ndihmën e bashkisë. -Emigrimi dibranëve, u thashë, u ba befas. Edhe unë që më kujton për të pasun, jam nevojtar. Tetmbëdhjet pare buke për frymë u epni në ditë. Nuk duhet t'ia kurseni ati që ta zgjasi dorën. Qeveria duhet ta ketë parasysh edhe pikpamjen politike me ndihmën që u ban emigrantëve. Në këtë mënyrë qe mundue me u dhanë të kuptojnë që t'u pengojnë prerjen e dibranëve kah Esati, por qe e pamundun me u marrë vesht. Mbas disa kohe u ndalue ndihma. Për këtë shkak shumica e emigrantëve që ndodhesahin në Elbasan, shkuen në Tiranë. Edhe kjo ngjarje i ndihmoi Esatit për realizimin e qëllimit të tij.

***(Vijon)***

## *NË NUMRAT E ARDHSHËM DO TË LEXONI:*

**1- Mbas shpalljes së qeverisë së përkohshme të Shqiperis së mesme prej Esat Pashës.**
**1 - Arif Hikmeti në Dibër dhe veprimet e tij**
**2 - Mbas ardhjes së Princ Vidit në Durrës.**
**3 - Ç'pamë në Durrës.**
**4 - Mbasi u kthyem nga Durrsi në Dibër.**

***© Shënimet e Ismail Strazimirit botohen me lejen e Drita Agollit (Strazimirit) dhe Zeqi Agollit.***



**"Ja atje është Sina, vendlindja e Kastriotëve-flet Moisiu gati me dëshpërim, tani është e kotë që të shkoni. E para rruga është bërë shumë e vështirë. E dyta, muzeu që ndërtuam në 1985 tani më mirë të mos e shihni. Kemi kërkuar fonde për rindërtimin e tij po kush përgjigjet. Na duhen vetëm 1. 5 milion. Kushedi…"**

# Në Dibër, te pronat e Skënderbeut

## *Pas gjurmëve të Gjergjit nga Vajkali në Kastriot*

**Nga FATOS BAXHAKU**

Bulqizën e gjejmë të vaposur fare. Në fillim kishim pasur disa shpresa të vagullta se mbase me të kaluar Qafën e Bullit do të shijonim pak freski, porse këto shpresat tona, si zakonisht, rezultuan të kota. Bulqiza është po aq e vaposur dhe po aq e lodhur nga dielli sa edhe Tirana që kemi lënë pas para disa orësh. Qyteti i minatorëve të kromit ka po atë pamje që kemi parë para do kohësh. Po ato njerëz që shkojnë pa kuptim rrugëve, ndonjë i ri që shpejton të blejë gazetën e basteve dhe dyqanxhinjtë e vegjël që presin me sytë nga rruga se mbase ndokush do kujtohet për to.

Ne endemi për pak minuta mes lokaleve të stërmbushura me meshkuj dhe me muhabetet e Kampionatit botëror të futbollit, ndërsa na sillen në kokë ato shënime që kemi lexuar një natë më parë për Skënderbeun. Është pikërisht ky objektivi i udhëtimit tonë të kësaj jave. 562 vjet më parë Gjergj Kastrioti i fuqizuar nga Kuvendi i Lezhës, pat arritur të parën fitore kundër 25 mijë osmanëve të udhëhequr nga Ali Pasha.

Rruga i pat kaluar pikërisht këtej nga kjo luginë, që lidhte dikur Krujën me zonat e pushtuara nga osmanët. Ndokujt prej nesh i shkon ndërmend të pyes ndonjë gjë për Skënderbeun. Na duket e kotë. "Ama edhe ju ç'ia paskeni ngenë. E keni gjetur pikërisht kohën dhe vendin', do të na përgjigjej me siguri ndonjëri nga minatorët që priste në vapë t'i vinte turni për të zbritur në zemër të tokës. Në Bulqizë ka dy monumente. Më saktë një monument i bronxtë që paraqet një minator krenar dhe një bust tjetër, më i vogël prej allçie i lyer në varak të verdhë që duket edhe më vezullues se ç'është nga dielli që i bie pingul. Është busti i një njeriu të mirë islam që pat bërë dikur bamirësi të pafundme. As që bëhet fjalë për ndonjë rrugë a shkollë me emrin e Gjergjit. Të paktën ne në qendër nuk dalluam asnjë. E kuptojmë se që të takojmë Skënderbeun, apo të paktën hijen e tij duhet ta lëmë Bulqizën në hallet e saj.

### Vajkali tragjik

Po ta shohësh nga xhadeja, nuk të shkon aspak mendja se po kalojmë pikërisht në krah të njërit prej fshatrave më të njohur të historisë së Skënderbeut. Vajkali është një emër që e pat bërë të njohur shkodrani Marlin Barleti, historishkruesi më i njohur i bëmave të Skënderbeut. I vendosur në krah të majtë të Zallit të Bulqizës – sikurse e quajnë vendasit një përrua që derdhet më pas në Drin të Zi – Vajkali nuk ka asnjë ndryshim nga fshatrat e tjerë të Dibrës së Poshtme. Po ato kopshtije të rregulluara mirë, po ato çati të kuqe dhe po ajo qetësi që i zë të gjithë fshatrat në kohë zhegu. Barleti pat shkruar se pikërisht në këtë luginë, Skënderbeu ishte ndeshur dy herë me një ushtri të stërmadhe të komanduar nga Ballaban Pasha. Në fakt më shumë se një luftë e përgjakshme mes arbërve dhe osmanëve betejat e Vajkalit duken se kanë qenë një sfidë personale midis dy jeniçerëve shqiptarë. Edhe Ballabani , shqiptar nga Mati, njësoj si Kastrioti kishte qenë fëmijë i krishterë, i rritur pranë kazanit të jeniçerëve. Sfida mes tyre do të vazhdojë gjatë, derisa Ballabani do të vritet në një prej rrethimeve të fundit të Krujës. Sido që të jetë, dihet se Ballabani i zuri rob Skënderbeut pikërisht në Vajkal, shtatë njerëzit e tij më të afërt, midis të cilëve edhe Dibranin Moisi Golemi. Të shtatë fisnikët shqiptar u rropën të gjallë në një shesh të Stambollit, pasi nuk pranuan të ndërronin fenë. Ishte vera e 1465. Moisiu e pat tradhtuar Skënderbeun do kohë më parë. Tradhtinë e lau me martirizim, njësoi si burrat e vërtetë të qëmotit. Ndanë xhadesë që të çon në Peshkopi, na bëjnë pështypje disa gurë ndanë një fushe që zbret në Zallin e Bulqizës. Këto ne i quajmë gurët e Skënderbeut, bën me kokë shoqëruesi ynë, ndërsa makina jonë frenon menjëherë. Janë vërtet të çuditshëm Gurët e Skënderbeut. Duket se janë rrokullisur dikur nga mali, porse ndryshe nga shkëmbi të cilit duhej ti përkisnin që është krejt i bardhë, ato janë krejt të zinj. "Të jenë përdorur vërtet kundra osmanëve", është pyetja e parë që të shkon ndërmend. Në këto anë rrokullisja e shkëmbinjëve për në fushë është një gjë që ndodh thuajse përditë. Sido që të jetë, vendasit i kanë quajtur"Gurët e Skënderbeut" dhe neve na kujtohen sakaq historitë e mësuara në shkollë, atëherë kur na thoshin se luftëtarët e Skënderbeut hedhjen e shkëmbinjëve nga lartësitë e kishin njërën prej armëve më të sukseshme. Një makinë nusje me bori marramendëse që kalon para nesh na rikthen në kohët e sotme. Makina ndalon pak metra më tutje, atje ku është një vend i shenjtë në kujtim të Sheh Çaush Çangës. Nusja e dhëndri as që nuk i kthejnë sytë nga gurët e Skënderbeut. Vazhdojnë përpara duke shikuar me admirim Teqenë e Çaushit. Njësoi si karvani i dasmorëve, e harrojmë dhe ne Gjergjin sërish për pak kilometra.

### A është pelë a dhi?

Peladhia është një fshat i fshehur në hijet e shumta poshtë xhadesë. Është një fshat relativisht i madh, me shtëpitë e mbajtura dhe me kopshtet e lulëzuara. Në fillim patëm përshtypjen se këtu, në këtë ndalesë nuk do të kishim të bënim më me Skënderbeun. Porse ja ku del sërish emri i Gjergjit. Fshatarët besojnë se në kohën kur Fushë Bulqiza gëlonte nga osmanët, Skënderbeu qe tërhequr në malet rrotull. Ushtritë e Sulltanit kishin vendosur të ndërronin taktikë. Në vend të një lufte frontale, kishin vendosur t'i prisnin atij furnizimet. Kështu patën kaluar goxha muaj. Osmanët prisnin me durim që njerëzve të Kastriotit t'u mbaroheshin ushqimet, ndërsa dimri i ashpër i këtyre anëve kishte nisur të afrohej pak nga pak. Pikërisht atëherë thuhet se ka hyrë në lojë një nga dredhitë e famshme të Gjergjit. Një pelë e stërushqyer me elb u gjend befas para këmbëve të ushtarëve turq. Për turqit dukej sheshit se kafsha e ngratë kishte rënë nga shkrepat e njerzve të ushtarëve të Skënderbeut. 'A është pelë a është dhi"?- kanë pyetur veten ushtarët. Por më shumë se emri i kafshës turqve u ka bërë pështypje ushqimi i bollshëm që mushka kishte marrë me vete në humnerë, drejt vdekjes. Ca nga dimri që po vinte dhe ca ngaqë kujtuan se Skënderbeu kishte ushqim të bollshëm edhe ca muaj, turqit tërhoqën rrethimin. Thuhet se në kohën kur Skënderbeu e sajoj këtë rreng, kishte vetëm pak dit ushqim. Peladhia vazhdon të ekzistojë, po atje, në vendin ku janë sajuar këto histori të çuditshme mesjetare. Të moshuarit flasin shumë. Vetëm një lis shekullor në qendër të fshatit hesht. Mbase është i vetmi dëshmitar i gjallë i këtyre historive. Heqim ca të shohim Valikardhën, një fshat tjetër që na lidh me heroin. Është fare e mbuluar nga gjelbërimi, aq sa nuk duken edhe çatitë flakë të kuqe. Në anë të rrugës që të çon në Zerqan, na kujtohen ato që kemi kënduar në libra. Në Valikardhë në 1464 kur Skënderbeu shpresonte të bashkohej me Huniadin në Serbi, pat lënë këtu një garnizon të besuar nën komandën e Antonio da Cosenza një kondotier Italian. Skënderbeu në shtator i ndryshoi planet dhe iu kthye Ohrit. Në Valikardhë, në fshatin e sotëm paqësor, u pat mbledhur e tërë plaçka e luftës që vinte nga Ohri. Kondotieri Italian u ka raportuar shefave të tij me hollsi listën e plaçkës që Skënderbeu u zuri osmanëve.


### Nga Peshkopia në trojet e Gjergjit


Peshkopia në këtë behar mban erë bliri. Qyteti i sotëm nuk ka ndonjë lidhje të vetën direkte me Skënderbeun, porse të gjithë fshatrat rreth e rrotull janë lidhur me të në mënyrë të pazgjidhshme. Njësoi si në Bulqizë, ndërsa shëtisim në bulevardin e veshur nga blirët, mundohemi më kot të gjejmë ndonjë shenjë të Gjergjit. Edhe këtu do të hasim vetëm dy buste. I pari është ai i Elez Isufit, kryeprijës i shqiptarëve në mbrojtje të trojeve, nga i cili ka marrë emrin bulevardi kryesor i qytetit dhe i dyti është Gjok Doçi, një djalë i Lurës, partizan i vrarë diku andej nga Mallakastra, në 1944. Për ca kohë do ta vrasim mendjen. Na u duk sikur befas i humbëm gjurmët e Gjergjit. Por ja ku takojmë rastësisht Moisi Kamberin, historian, drejtor i muzeut të Peshkopisë dhe bashkëstudenti ynë. Moisiu na vë menjëherë në dispozicion ato pak dokumente që kanë mbetur nga muzeu i vjetër i rrethit. Nën një fasadë tipike të kohës së miqësisë shqiptaro-sovjetike-muzeu i ri-Moisiu na shpjegon me durim historinë e prejardhjes dibrane të Kastriotëve. Dëgjojmë edhe njëherë toponimet:Kulla e Gjonit, Pusi i Gjonit, Kodra e Gjonit, Ara e Gjonit. Brenda pak çastesh takuam edhe Shemsi Zunën, një plak i moçëm nga Çidhna ku përfshihet edhe Kastrioti. "Gjishi"sikurse e thërresin të gjithë Shemsiun në Peshkopi, na tregon se rrëfimet e para për Skëndërbeun i pat dëgjuar gjysmë vjedhuri nga më të moçmit, kur bënin muhabet të gjatë në odën e burrave. Ma vonë e kam ndjek vetë historinë se e pëlqej shumë, vazhdon "Gjishi" që bashkë me Moisiun shpejtojnë të na shoqërojnë për në Kastriot.

Para se të nisemi kemi pak kohë për të parë Peshkopinë e vjetër. Një grumbull shtëpish majë një kodre na afrojnë edhe më shumë me historitë e vjetra, në kërkim të të cilave jemi. Rrugën e pluhurosur për në kastriot e kalojmë brenda pak minutash. "Ja atje poshtë matanë lumit është Sina, vendlindja e Kastriotëve-bën me gisht 'Gjishi"kurse ajo fusha atje akoma edhe sot e kësaj dite quhet Fusha e Kastriotëve. Ndërsa udhëtojmë për në fshat kalojmë një repart të vjetër ushtarak. Kjo luginë ka qenë gjithmonë një pikë e rëndësishme strategjike si për ato që mbroheshin ashtu dhe për ato që sulmonin. Bashkë me Moisiun dhe "Gjishin" takojmë Zenel Doçin një tjetër të moshuar. Zeneli afro tetëdhjetave i mban mend nga koha e fëmijrisë gërmadhat që u zhdukën pas nga punimet në xhade apo nga hapja e tokave të reja. "I mbaj mend si sot andej nga kisha –flet ngadalë Zeneli-kur nisën punimet dilnin vazhdimisht gurë të vjetër të lidhur me gëlqere. Kudo që të gërmosh tek ne dalin rrënoja të vjetra"Ndersa biseda lidhet sa nga historitë e vjetra në të sotmen, një sixhade e varur në murk u paraqitet Meka na kujton edhe një herë se dy bashkëbiseduesit tanë janë nga besimtarët më të zellshëm islam. Histori, kuriozitete të flasësh për Gjergj Kastriotin-pallë e fortë e krishtërimit e patën quajtur dikur-me Mekën mbi krye, jo kushdo mund ta ketë fatin që të jetë njëherësh edhe në Islam edhe në Krishtërim. Me "Gjishin" dhe Zenelin përshëndoshemi në të dalë të fshatit. "Ja atje është Sina, vendlindja e Kastriotëve-flet Moisiu gati me dëshpërim, tani është e kotë që të shkoni. E para rruga është bërë shumë e vështirë. E dyta, muzeu që ndërtuam në 1985 tani më mirë të mos e shihni. Kemi kërkuar fonde për rindërtimin e tij po kush përgjigjet. Na duhen vetëm 1. 5 milion. Kushedi… Makina jonë sërish hyn në rrugën e kthimit. Lëmë pas legjenda, kujtime, data dhe ngjarje, emra të vjetër. -E kemi marrë pak dhe nga vendi i Kastriotëve, bën shaka njëri prej nesh duke parë nga makina që e ka humbur ngjyrën e saj të parë dhe i ngjan një grumbull të kafenjtë shëtitës. E takojmë edhe njëherë Zall Bulqizën, përroin ku dikur pat rrjedhur aq shumë gjak. Uji ka nisur të bëhet pis i errët. Është takimi i fundit me historitë e vjetra të Gjergj Kastriotit.

*(Marrë me shkurtime nga gazeta "Shqip")*


## Botime të autorëve dibranë











# Klubi sportiv Korabi tashmë edhe pingpong...

Korabi, i shquar në sportet e mundjes, alpinizimit, volejbollit etj, tani po njihet edhe në sportin e Pingpongut. Ky sport, prej 5 vitesh, është bërë pjesë e pandarë e aktiviteteve sportive të klubit në rrafsh lokal e kombëtar.

Trajnieri Pajtim Shehu, edhe pse ende pa një palestër, si gjënë më elementare, po punon me përkushtim që ky sport të zërë vendin e elitës në Klubin Sportiv "Korabi".



Në kampionatin kombëtar që u zhvillua në Durrës më datë 8 - 9 korrik 2006, "Korabi" zuri vendin e katërt. Kjo ishte një arritje e madhe, pasi ishte hera e parë që pingpongistët e Korabit merrnin pjesë në një aktivitet të tillë.

Në kampionatin lokal, që është zhvilluar në Peshkopi në vitin 2003, i riu **Argjend Shehu** zuri vendin e parë dhe vazhdon ende ta mbaj këtë titull. Argjendi, djali i futbollistit Mufit Shehu, ka kohë që ecën në gjurmë të babait, por me një ndryshim, ka zvogëluar përmasat e fushës dhe topit të futbollit: Po shkëlqen në pingpong! Argjendi ishte një nga katër lojtarët më të mirë të kampionatit kombëtar që u mbajt në Durrës.

Djemtë e Korabit në pingpong nuk i kanë akoma kushtet për stërvitje. Nuk kanë një palestër të tyre, nuk kanë as financime, por falë punës së trainerit Pajtim Shehu, ata i kanë vënë vetës një qëllim: Në kampionatin e pingpongut të trevave shqiptare, që do të organizohet në qytetin e Dibrës së Madhe, do të zënë vendin e parë.

Ky është premtimi i pingpongistëve të Korabit, që do të bëhet realitet! Sepse ata djem dhe traineri i tyre e meritojnë këtë!

# Libër me vlera jo vetëm për fisin Hysa por për gjithë Dardhën

Më datë 16 qershor 2006, në një nga sallat e hotel Rogner, u bë promovimi i librit "Hakik Hysa i Dardhës" (Veprimtaria e fisit Hysa në të dyja anët e Drinit të zi) me autor Shaqir Skarra dhe Ismail Hysa.




Të pranishëm në sallë nuk ishin vetëm përfaqësues të komunitetit të fisit Hysa, por edhe studiues, gazetarë të mediave të shkruara dhe atyre vizive, intelektual të Dibrës dhe rretheve të tjera.

Diskutantët e shumtë përgëzuan autorët për këtë libër, ndoshta të thjeshtë në përmbajtje, por që mbetet gjithmonë pasaporta e fisit Hysa. Në diskutimet e shumta ndër të tjera u tha: Duke hulumtuar rreth etnogjenezës së këtij fisi, duke arritur që autorët të bëjnë pemën gjenaologjike të fisit Hysa deri në tetë breza, duke pasqyruar me vërtetësi dhe dokumenta të sakta mbi gjithçka lidhet me këtë fis dhe trevën e Dardhës, autorët pas një pune të gjatë dhe të lodhshme, kanë arritur të realizojnë një vepër të mirë dhe të pranueshme. Fundja vetë historia fillon tek fisi dhe ky libër është një histori e gjallë e fisit Hysa në të dyja anët e Drinit të Zi.

Figurë qendrore në libër, padyshim që është Hakik Hysa. Në faqet të këtij libri portreti i tij del i plotë. Një plak tipik malsor i këtyre anëve, sa i mençur aq dhe trim, sa bujar aq dhe i besës, sa i dashur me miqt, aq dhe i pamëshirshëm me pushtuesit e vendit.

Në fund, për të pranishmit u këndua posaçërisht kënga kushtuar plakut të maleve Hakik Hysa nga këngëtari virtuoz dibranë Sherif Dervishi, i cili me zërin e tij elektrizoi gjithë sallën.




# "Me këngën jam rritur"

Këngëtarët virtuoz Arif Vladi dhe Qerim Vladi tashmë nuk janë vetëm.Edhe Zaim Tollja nga Lura është dhe për publikun sapo ka ka nxjerrë albumin e parë në treg "Pasha sytë e tu"

Zaimi ka mbaruar shkollën e muzikës "Prenkë Jakova " në Shkodër për kanto dhe pas shkollës nuk pati mundësi ta demonstrojë bukur këngën me të cilën ishte i lidhur qysh fëmijë.Pas mbarimit të shkollës filloi punë mësues muzike në vendlindje dhe pas pak kohësh do të punonte në shtëpinë e kulturës Lurë si metodist.-Kënga nuk erdhi rastësisht tek unë , thotë Zaimi.Si unë ashtu dhe vëllai im më i madh




Arifi i cili sot ka ka në arkivin e radio Tiranës këngët e Gjokë Doçit dhe Prej merakut tand çeli trandafili me tekst dhe muzikë të folkloristit të njohur të Lurës dhe gjithë Dibrës Hilmi Kolgjegja.Ishte nëna ajo që më ushqeu si mua dhe vëllait dashurinë për këngën.E dëgjonin shpesh-herë kur ajo në prani tonë këndonte këngën e fushës së Korabit.Zaimi vonë tepër vonë filloi të aktivizohej dhe të ngjitej në skenë megjithse qysh kur ishte i vogël përgjegjsi i kulturës në atë periudhë në Lurë Halim Laçi e merrte me vete dhe e ngjiste në një karrike që të këndonte.Ishte pikërisht ansambli "Shqiponja" që i bëri ftesë Zaimit për të shkuar me dhënë koncerte në shumë qytete të Turqisë.Sot me zërin e tij të mrekullueshëm, me këngët lirike por dhe ato epike Zaim Tollja është ngjitur në skena brenda dhe jashtë vendit.Por Zaimi nuk është vetëm një këngëtar virtuoz.Shumë tekste këngësh si dhe muzika kanë për autor Zaimin megjithse ai bashkëpunon rregullisht me Bruno Qerimin.Së shpejti do të kemi fatin të shikojmë dhe videoklipin e tij.-Puna me këngën nuk ka të mbaruar, thotë vetë Zaimi. Ajo është një udhë e gjatë por shumë e bukur.Unë sapo jam nisur drejt kësaj udhe.



## FTESË

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët. Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

**Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.**

**Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.**
**Email: lid_gazeta@yahoo.com**

## KONKURS

**Në kuadër të botimit të kalendarit "Dibra 2007", ftojmë të interesuarit, fotografë dhe amatorë, të sjellin fotografitë e tyre për kalendarin. Fotografitë do të përzgjidhen nga stafi i botimit të kalendarit. Fotot që do të botohen do të shpërblehen. Fotot duhet të jenë të shoqëruara me një shënim shpjegues, por jo më të gjatë se 30 karaktere.**
**Fotografitë duhet të jenë dixhitale ose të stampuara në format kartoline të shoqëruara me negativin.**

**Për më shumë informacion telefononi në numrin: (04) 233 283 ose shkruani në email: mbujar@yahoo.com**

*Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745***